



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.²⁸..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 31/ 01 / 2025

VENDIM

Nr. 02, datë 31/01/2025

PËR

**MBIKQYRJEN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT PËR REHABILITIMIN E DIGËS SË
GADUROVËS TË SHFRYTËZUAR NGA BASHKIA MALLAKASTËR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 20 dhe 27, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 31.01.2025 mori në shqyrtim Kërkesën e Bashkisë Mallakastër për miratimin e mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit për Rehabilitimin e digës së Gadurovës që shfrytëzohet nga Bashkia Mallakastër.

Mbikqyrësi i punimeve "SELAS" shpk me NIPT J71826005F dhe me drejtues Ligjor dhe teknik ing. Vladimir Agalliu i caktuar nga Bashkia Mallakastër për të mbikqyrur punimet për rehabilitimin e digës së Gadurovës që shfrytëzohet nga kjo Bashki, sipas dokumentacionit të dorëzuar pranë KKDM rezultoi se është me përvojë në punimet e ndërtimit të veprave hidroteknike dhe sidomos të digave dhe është i pajisur me licencën përkatëse për mbikqyrjen e punimeve në diga.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antarëve të KKDM të miratoj Mbikqyrësin e punimeve të ndërtimit për rehabilitimin e digës së Gadurovës sipas kërkesës të paraqitur nga Bashkia Mallakastër. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

1. Të miratoj kërkesën e Bashkisë Mallakastër për miratimin e kompanisë "SELAS" shpk si Mbikqyrësin e Punimeve të ndërtimit për rehabilitimin e digës së Gadurovës.
2. Ti kërkoj Bashkisë Mallakastër:
 - Në përfundim të punimeve të ndërtimit, Mbikqyrësi i punimeve duhet të përgatit një raport të plotë të shoqëruar me të gjithë dokumentat përkatëse dhe një kopje e këtij raporti të dërgohet pranë KKDM dhe grupit të Kolaudimit sipas kërkesave të Nenit 20 të VKM së mësipërme;
 - Të kryejë Kolaudimin sipas kërkesave të Nenit 24 të VKM së mësipërme.
 - Pas përfundimit të punimeve të Rehabilitimit dhe rivenies në punë të digës së Gadurovës, përgatitjen e hartave të përmbytjeve për kushtet e reja dhe përcaktimin e zonave me rrisht të lartë në rastet e prurjeve maksimale të ujit me përsëritje një herë në 100 vjet, 1 herë në 1000 vjet dhe në rast të prishjes së mundshme të digës.
 - Dorëzimin e projektit të zbatimit sipas faktit pas përfundimit të punimeve të parashikuara për rehabilitimin e kësaj dige si dhe dorëzimin e Aktit të Kolaudimit të punimeve për miratim pranë KKDM sipas kërkesave të nenit 25 të VKM Nr. 147 të mësipërme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI